

## AKTI I THEMELIMI

### SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “GP HOLDING GREEN ECONOMY” sh.p.k

Sot, në Tiranë, më datë 10.11.2020 personat e mëposhtëm:

**Pompeo Panichi**, atësia Andrea, amësia Elda Migliorati, datëlindja 12.05.1968, lindur në Ancarano(TE) banues në Itali, Via Goffredo Mameli, 2 Sant; Egidio Alla Vibrata(TE), titullar i letërnjoftimit me nr CA42714HM, lëshuar nga autoritetet italiane në datën 29.10.2020.

**Emidio Pagliacci**, atësia Attilio, amësia Isolina di Girolamo datëlindja 13.03.1961, lindur në Ascoli Piceno, banues në Itali, San Benedetto Del Tronto, Via Esiono nr. 83, titullar i letërnjoftimit me nr. 4475958AA, lëshuar nga autoritet Italiane dt. 01.09.2015, themelojnë shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “GP HOLDING GREEN ECONOMY” sh.p.k dhe hartojnë për këtë qëllim Aktin e Themelimit të shoqërisë me përmbajtje si vijon:

#### NENI 1

#### EMËRTIMI I SHOQËRISË

1.1 Emërtimi i shoqërisë është “GP HOLDING GREEN ECONOMY” sh.p.k.

#### NENI 2

2.1 Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht në Ligjin 9901 dt 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe për këtë qëllim hartojnë Aktin e Themelimit të tij, me përmbajtjen si vijon:

#### NENI 3

#### FORMA

3.1 Shoqëria “GP HOLDING GREEN ECONOMY” sh.p.k, është Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar sh.p.k.

#### NENI 4

4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, rruga “Riza Cerova” nr., 25.

#### NENI 5

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

5.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë përfshin:

Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjise elektrike.

Projektimi, ndertimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve per prodhimin e energjise elektrike dhe infrastruktura e impianteve.

Kerkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave per prodhimin e energjise.

Asistenca teknike, riparime dhe mirembajtje e aparaturave per prodhimin e energjise.

Import - eksporti, tregtimi me shumice dhe pakice i energjise elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave qe lidhen me kryerjen e aktivitetit te shoqerise

Konsulence, ekonomike, financiare, manaxheriale, shitjeje, konsulencë për kredimarrje në sistemin bankar shqiptar, hartim plani biznesi, studim tregu, konsulencë marketing dhe promovim aktiviteti të subjekteve, konsulencë në burokrat, qerëzore, shërbime përfaqësimi ndaj subjekteve dhe individëve,

KLODIAN MURRISI  
PËRKATHYES I BASHKËPUNËS  
TRADUTTORE GJURIDIK  
0698193399

POMPEO PANICHI

Elda

vendas apo të huaj, ndermjetesim financiar dhe trajnime etj., për bizneset dhe individët, si dhe çdo shërbim financiar dhe kontabël të lejuar nga legjislacioni shqiptar për këtë lloj shoqërie që ka lidhje me këtë object veprimtarie.

Import eksport tregeti me shumice e pakice, tregetim te mallrave industriale, ushqimore, fruta perime, pije te ndryshme alkoolike e freskuese, veshmbathje, materiale ndertimi, pjese kembimi automjete, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobiljeve, artikujve kozmetike të përpunuara dhe të papërpunuara, bimë medicinale, lende drusore plastike dhe duralumini dhe cdo lloj malli të lejuar nga legjislacioni shqiptar për këtë lloj shoqërie.

Aktivitet në fushën e agjensisë imobiliare, shitje blerje pasurish të luajtshme dhe/ose të paluajtshme dhe cdo veprimtari e lidhur me të.

Aktivitet në fushën e ndërtimeve civile dhe industrial të të gjitha llojeve.

Për kryerjen e aktivitetit të shoqërisë së mesipërme, për të cilin do të nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

## NENI 6

6.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë mbi 10 vjet dhe do të fillojë nga momenti i regjistrimit të saj në Qendren Kombetare të BIZNESIT me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos asambleja e ortakëve.

## NENI 7 TERRITORI

7.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, gjithashtu ajo mund të hapë, filiale, degë, ose përfaqësi në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, apo në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vëndeve përkatëse.

## NENI 8 KAPITALI DHE PJESËT

8.1 Kapitali i shoqërisë ka vlerën 100 000 lekë, i cili ndahet në 2 kuota. Vlera e kapitalit të shoqërisë është tërësisht i rimbursueshëm me kontributin e ortakëve sipas raportit të ortakëve.

8.2 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të jashtëzakonshme (parashikuar në statutin e shoqërisë). Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të pjesëve të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e pjesëve të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.

8.3 Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të jashtëzakonshme (parashikuar statutin e shoqërisë). Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që ata përfaqësojnë.

## NENI 9 KONTRIBUTET

9.1 Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga ortakët e shoqërisë, **Pompeo Panichi** dhe **Emidio Pagliacci** si vijon:

9.2 Ortaku **Pompeo Panichi**, zotëron një kuotë, baraz me 50 % të të gjithë vlerës së kapitalit, me vlerë totale prej 50 000 lekë (pesëdhjetëmijë).

9.3 Ortaku **Emidio Pagliacci**, zotëron një kuotë, baraz me 50 % të të gjithë vlerës së kapitalit me vlerë totale prej 50 000 lekë (pesëdhjetëmijë). Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

9.4 Vlera e kapitalit të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

KLODIAN KOVARI  
PERKTHYES I BETUAR  
TRADUTTORE GIURATO  
0698193389

Pompeo Panichi

Për nevoja të punës dhe të ushtrimit të aktivitetit të saj shoqëria mund të çelë llogari në çdo bankë të njohur me ligj, qoftë kjo private ose shtetërore.

## NENI 10 ADMINISTRIMI

**10.1** Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.

**10.2** Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është jo më shumë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në çdo kohë.

**10.3** Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**10.4** Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblesë së përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

## NENI 11 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

**11.1** Administratorëve iu njihet e drejta për të ushtruar të gjitha kompetencat për kryerjen e veprimeve të administrimit dhe të përfaqësimit në emër të shoqërisë, në interes të saj dhe nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e Shoqërisë, Principet e Biznesit dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve të shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe statuti ia japin shprehimisht ortakëve.

## NENI 12 EMËRIMI I PARË I ADMINISTRATORËVE

**12.1** Administrator i parë i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare **Pompeo Panichi**, atësia Andrea, amësia Elda Migliorati, datëlindja 12.05.1968, lindur në Ancarano(TE) banues në Itali, Via Goffredo Mameli, 2 Sant; Egidio Alla Vibrata(TE).

Akti i Themelimit u përpilua në gjuhën shqipe, në katër kopje origjinale, duke pasur të gjitha fuqitë ligjore të barabarta për t'u administruar sipas ligjit.

## ORTAKËT THEMELUES

**Pompeo Panichi**

POMPEO PANICHI  
Pope R

**Emidio Pagliacci**

Pagliacci Emidio

I PRANISHËM NË NËNSHKRIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT PËRKTHYESI

Klodian Kovaçi, atësia Petrit, amësia Françeskina, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në TIRANË, me adresë E Dibrës; Nd. 398; H. 1; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1005; Tiranë, lindur më 10/09/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 035688090 dhe nr. personal I00910100W

Klodian Kovaçi

KLODIAN KOVAÇI  
PËRKTHYESI BETUAR  
TRADUTTORE GIURATO  
0698193399

POMPEO PANICHI  
Pope R

Emidio Pagliacci



**STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“GP HOLDING GREEN ECONOMY” sh.p.k**

**HYRJE**  
**NENI 1**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “GP HOLDING GREEN ECONOMY” sh.p.k është themeluar nga ortakët:

**Pompeo Panichi**, atësia Andrea, amësia Elda Migliorati, datëlindja 12.05.1968, lindur në Ancarano(TE) banues në Itali, Via Goffredo Mameli, 2 Sant; Egidio Alla Vibrata(TE), titullar i letërnjoftimit me nr CA42714HM, lëshuar nga autoritetet italiane në datën 29.10.2020.

**Emidio Pagliacci**, atësia Attilio, amësia Isolina di Girolamo datëlindja 13.03.1961, lindur në Ascoli Piceno, banues në Itali, San Benedetto Del Tronto, Via Esiono nr. 83, titullar i letërnjoftimit me nr. 4475958AA, lëshuar nga autoritet Italiane dt. 01.09.2015

Themeluesit, të cilët janë madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me ligjin hartojnë edhe statutin e Shoqërisë si më poshtë:

**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Emërtimi i shoqërisë është “GP HOLDING GREEN ECONOMY” sh.p.k.

**NENI 2**

Shoqëria ushtron aktivitetin në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë vecanërisht sipas ligjit 9901 dt 14.04.2008, “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të BIZNESIT.

**NENI 3**  
**FORMA**

3.1 Shoqëria “GP HOLDING GREEN ECONOMY” sh.p.k është “Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar” Sh.p.k.


**NENI 4**

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, rruga “Riza Cerova ndertesa nr. 25.


**NENI 5**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

5.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë përfshin:

- Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjise elektrike.
- Projektimi, ndertimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve per prodhimin e energjise elektrike dhe infrastruktura e impianteve.
- Kerkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave per prodhimin e energjise.
- Asistenca teknike, riparime dhe mirembajtje e aparaturave per prodhimin e energjise.

  
**Pompeo Panichi**

**KLODIAN KOVACI**  
**PERKTHYES I BETUAR**  
**TRADËTTORE GIURATÇ**  
0698193399



Import - eksporti, tregtimi me shumice dhe pakice i energjise elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave qe lidhen me kryerjen e aktivitetit te shoqerise

Konsulence, ekonomike, financiare, manaxheriale, shitjeje, konsulencë për kredimarrje në sistemin bankar shqiptar, hartim plani biznesi, studim tregu, konulencë marketing dhe promovim aktiviteti të subjekteve, konsulencë në burimet njerëzore, shërbime përfaqësimi ndaj subjekteve dhe individëve, vendas apo të huaj, ndermjetesim financiar dhe trajnime etj., për bizneset dhe individët, si dhe çdo shërbim financiar dhe kontabël të lejuar nga legjislacioni shqiptar për këtë lloj shoqërie që ka lidhje me këtë object veprimtarie.

Import eksport tregeti me shumice e pakice, tregetim te mallrave industriale, ushqimore, fruta perime, pije te ndryshme alkoolike e freskuese, veshmbathje, materiale ndertimi, pjese kembimi automjete, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobiljeve, artikujve kozmetike të përpunuara dhe të papërpunuara, bimë medicinale, lende drusore plastike dhe duralumini dhe cdo lloj malli të lejuar nga legjislacioni shqiptar për këtë lloj shoqërie.

Aktivitet në fushën e agjensisë imobiliare, shitje blerje pasurish të luajtshme dhe/ose të paluajtshme dhe cdo veprimtari e lidhur me të.

Aktivitet në fushën e ndërtimeve civile dhe industrial të të gjitha llojeve.

#### NENI 6

6.1 Kohëzgjatja e shoqerisë do të jetë mbi 10 vjet dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

#### NENI 7

##### TERRITORI

7.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, gjithashtu ajo mund të hapë, filiale, degë, ose përfaqësi në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, apo në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

#### NENI 8

##### KAPITALI I SHOQERISE DHE PJESET

8.1 Kapitali i shoqërisë ka vlerën 100 000 (nëqindmijë) lekë cili ndahet në 2 kuota. Vlera e kapitalit të shoqërisë është tërësisht i rimbursueshëm me kontributin e ortakëve sipas raportit të ortakëve.

8.2 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të jashtëzakonshme. Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit te pjesëve te reja, ortakët kanë të drejtën e përparësise në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e pjesëve të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.

8.3 Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të jashtëzakonshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njejtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që ata përfaqësojnë.

#### NENI 9

##### KONTRIBUTET

9.1 Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga ortakët e shoqërisë, **Pompeo Panichi** dhe **Emidio Pagliacci** si vijon:


KLODIAN KOVACI  
PERKTHYES I BETUAR  
TRADUTTORE GIURATO  
0698173399



9.2 Ortaku **Pompeo Panichi**, zotëron një kuotë, baraz me 50 % të të gjithë vlerës së kapitalit, me vlerë totale prej 50.000 lekë (pesëdhjetëmijë).

9.3 Ortaku **Emidio Pagliacci**, zotëron një kuotë, baraz me 50 % të të gjithë vlerës së kapitalit me vlerë totale prej 50 000 lekë (pesëdhjetëmijë). Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

9.4 Vlera e kapitalit të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

Për nevoja të punës dhe të ushtrimit të aktivitetit të saj shoqëria mund të çelë llogari në çdo bankë të njohur me ligj, qoftë kjo private ose shtetërore.

#### NENI 10

#### TRANSFERIMI I KUOTAVE TE KAPITALIT

10.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë janë të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe te transferueshme në rrugë trashëgimie. Trashëgimtari, paraardhësi ose pasardhësi, bëhen ortakë, nëpërmjet transferimit të kuotave të kapitalit.

10.2 Kuotat e kapitalit te shoqërisë mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendim të marrë me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën mbi 50% të pjesëve të kapitalit.

10.3 Në rast kur njeri apo disa nga ortakët dëshirojnë të transferojnë pjesërisht apo plotësisht, kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë tek të tretët, më parë duhet që oferta për shitje t'u bëhet ortakëve të tjerë të shoqërisë, me të njëjtat kushte që do t'i bëhet të tretëve.

10.4 Transferimi i kuotave do të bëhet me kontratë.

#### NENI 11

11.1 Ortakët mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

#### NENI 12

#### ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë së Përgjithshme, dhe ka të drejtë vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

12.2 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi sipas ligjit nga një ortak tjetër, bashkëshorti ose nje person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë autorizuar me prokurë (përfshihet përfaqësimi i një ortaku nga administratori i shoqërisë).

12.3 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

12.4 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



KLODIAN KOVACI  
PERKTHYES I BETUAR  
TRADUTTORE GIURATO  
0698193399



**12.5** Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuar, po qe se ka të tilla, nga likuiduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Këta ortakë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do të bëhet me shkresë, ose nëpërmjet postës elektronike.

**12.6** Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

**12.7** Nëse në kundërshtim me pikën **12.5** të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi „Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“ i ndryshuar:

**12.8** Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme rregullisht bëhet nga administratori.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme dhe është përgjegjëse për to:

1. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit.
2. Emërimin dhe shkarkimin e administratorit të shoqërisë .
3. Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar.
4. Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar.
5. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
6. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë. (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit perkates).
7. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit(pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit perkates).
8. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
9. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
10. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
11. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
12. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

1. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
2. Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve.

Investime.

3. Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.


Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme

Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e Asamblesë së përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

Asambleja përgjithshme e Zakonshme vendos për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe Asambleja e zakonshme mund të marrë



**KLODIAN KOVACI**  
PERKTHYES I BETUAR  
TRADËTTORE GIURATO  
0698193399



vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave dhe vendimet merren me mbi 50% e pjesëmarrësve.

Asambleja e jashtëzakonshme vendos për çështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, transferimin tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve etj si dhe çdo çështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve të vlefshme behet vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 1/2 e kuotave, janë të pranishëm, votojnë me shkresë apo mjete elektronike. Në këtë rast vendimet merren me praninë e ortakëve pjesëmarrës që zotërojnë 3/4 të kuotave të kapitalit

Me përjashtim të rasteve të parashikuara me sipër, për çështjet e tjera të renditura në pikën 9 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në kete pikë, të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### NENI 13 ADMINISTRIMI

**13.1** Shoqëria administrohet nga nje ose me shume administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.

**13.2** Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorit nga organi kompetent mund të bëhet në çdo kohë.

**13.3** Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**13.4** Administratorit emërohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë Së Përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

### NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; të hapin llogari bankare në emër të shoqërisë.
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

  
  
KLODIAN KOVACI  
PERKTHYES I BETUAR  
TRADËTTORE GIURATO  
0698193399



f) administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme përsa parashikon ky statut ose ligji.

g) Administratorët administrojnë shoqërinë bashkërisht ose secili vec e vec.

h) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

#### NENI 15

#### EMËRIMI I PARË I ADMINISTRATORËVE

15.1 Administrator i shoqërisë është **Pompeo Panichi**, atësia Andrea, amësia Elda Migliorati, datëlindja 12.05.1968, lindur në Ancarano(TE) banues në Itali, Via Goffredo Mameli, 2 Sant; Egidio Alla Vibrata(TE).

Ai e ushtron detyrën e tij për një periudhë 5-vjeçare.

#### NENI 16

Për kryerjen e aktivitetit të shoqërisë së mesipërme, për të cilin do të nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

#### NENI 17

#### EKSPERTË KONTABËL TË AUTORIZUAR

16.1 Në rast nevoje si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga Asambleja e Zakonshme.

16.2 Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

#### NENI 18

#### VITI FINANCIAR

17.1 Çdo vit financiar fillon nga 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

#### NENI 19

#### LLOGARITË VJETORE

18.1 Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja e zakonshme.

18.2 Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.


#### NENI 20

#### DIVIDENTET

19.1 Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja e ortakëve përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendeve mbi fitimin proporcionalisht me përqindjen e pjesmarrjes së gjithsecilit në shoqëri. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcione me pjesët e kapitalit, përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm(5 % e fitimit të çdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

  
Pompeo Panichi

KLODIAN KOVACI  
PERKTHYES I BETUAR  
TRADËTTORE GIURATO  
0698193399





## NENI 21 PRISHJA

20.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të përcaktuar, kur kjo vendoset nga ortakët si dhe kur janë arësytet e parashikuara në ligj.

Shoqëria nuk priset kur njëri prej ortakëve falimenton, bëhet i paaftë ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjerë që kanë mbetur si dhe me trashëgimtarët e radhes së parë të ortakut që vdes.

## NENI 22 LIKUIDIMI

21.1 Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asambleja emëron një likuidues, i cili i paraqet asaj raportin e likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

21.2 Në fund të procesit të likuidimit Asambleja vendos me vendimin e ortakëve që zotërojnë të paktën mbi 50% të kuotave të kapitalit, mbi bilancin përfundimtar e financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit dhe për mbylljen e procesit të likuidimit.

21.3 Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së kuotave të kapitalit tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.

## NENI 23 SHNDËRRIMI I SHOQËRISË

22.1 Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në lloj tjetër shoqërie mund të kryhet vetëm me miratimin unanim të ortakëve .

## NENI 24 MOSMARRËVESHJET

23.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit midis ortakëve, ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.

## NENI 25

Për çështje që nuk janë parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Ky statut nënshkruhet nga themeluesit.

## ORTAKËT

**Pompeo Panichi**

**Emidio Pagliacci**

## I PRANISHËM NË NËNSHKRIMIN E STATUTIT PËRKTHYESI

Klodian Kovaçi, atësia Petrit, amësia Françeskina, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në TIRANË, me adresë E Dibrës; Nd. 398; H. 1; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1005; Tiranë, lindur më 10/09/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035688090 dhe nr. personal I00910100W

**Klodian Kovaçi**  
7

KLODIAN KOVACI  
PERKTHYESI BETUAR  
TRADËTTORË GIURATO  
0698193399



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER DHIMITRA XH. QARRI  
ADRESA BLV"BAJRAM CURRI",  
NR.24  
TEL: 697306457

# VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 3564

Tirane më 10/11/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2020053140259843221

REPubLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER DHIMITRA XH. QARRI



V2020053140259843221

DATE 10/11/2020  
NR REP 3564



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 10.11.2020, para meje Notere DHIMITRA XH. QARRI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, BLV "BAJRAM CURRI", NR.24, u paraqit personalisht shtetasi:

**Klodian Kovaçi**, atësia Petrit, amësia Françeskina, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në TIRANË, me adresë E Dibrës; Nd. 398; H. 1; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1005; Tiranë, lindur më 10/09/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035688090 dhe nr. personal I00910100W, i cili deklaroi i cili me vullnet të lirë dhe të plotë dhe të pavesuar, se është përkthyes zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë, dhe se ka qenë prezent dhe ka nënshkruar në aktin e themelimit dhe statutin shoqërisë "GP HOLDING GREEN ECONOMY" sh.p.k, në krijim e sipër, pasi ua ka lexuar keto akte ortakëve të saj **Pompeo Panichi**, atësia Andrea, amësia Elda Migliorati, datëlindja 12.05.1968, lindur në Ancarano(TE) banues në Itali, Via Goffredo Mameli, 2 Sant; Egidio Alla Vibrata(TE), dhe **Emidio Pagliacci**, atësia Attilio, amësia Isolina di Girolamo datëlindja 13.03.1961, lindur në Ascoli Piceno, banues në Itali, San Benedetto Del Tronto, Via Esiono nr. 83.

Në bazë të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", datë 20.12.2018, Unë noterja vërtetoj nënshkrimin e vënë në praninë time nga deklaruesi përkthyes Klodian Kovaçi.

Në bazë të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti noterial në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE  
DHIMITRA XH. QARRI